



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1034/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Simon Deda, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Simon Deda, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 12:00, ka pranuar një apel nga Simon Deda, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dega në Gjakovë, me të cilin kërkon që të rinumërohen votat në vendvotimet: 0222C/01R, 0222C/02R, 0222C/03R, 0222C/04R, 0222C/05R, në komunën e Gjakovës pasi që sipas parashtruesit të apelit aty ka pasur manipulime sepse i mungojnë votat e familjarëve të tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apeluesit gjeti se, apeluesi nuk ka ofruar asnjë provë për të dëshmuar pretendimet e tij ankimore në lidhje me mungesën dhe manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë. Prandaj

Paneli apelin e tij e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1034/2017 me datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.